



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL

Nr. 1087 prot.

Fier, më 24.01.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 04 datë 24.01.2025

“PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE PER FAMILJET NE NEVOJE QE DO TE TRAJTOHEN ME NDIHME EKONOMIKE DERI NE 6% TE FONDIT TE KUSHTEZUAR PER BLOK-NDIHMEN ME FONDET E PUSHTETIT QENDROR E VENDOR PER VITIN 2025”.

Mbështetur në nenin 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.139 date 17.12.2015 “Per vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, pika k; V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, te dokumentacionit dhe te masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per NE” (i ndryshuar), Udhezimit nr.5, date 17.02.2017 te MMSR “Per perfitimin e fondit te kushtezuar te bllok-ndihmes ekonomike deri ne 6 % (i ndryshuar), Drejtoria e Sherbimit Social,

Propozon:

- 1- Te rimiratoje kriteret per perdorimin e fondit te kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6% dhe ose me fondet e buxhetit vendor.
- 2- Familjet ne nevojë do te perzgjidhen nga lista e familjeve aplikuese brenda tre muajve te fundit, dhe qe nuk jane shpallur fitues nga sistemi i pikezimit.
- 3- Te trajtohen familje ne nevojë, ne kushte social-ekonomike te veshtira, pa te ardhura,ose me te ardhura te pamjaftueshme; gra k/familjare te vetme, te divorcuara, ne moshe te madhe,te veja, e me femije te mitur, jetim; k/familjar PAK ose anetare te tille qe nuk marrin pagese paaftesie;
- 4- Per familjet e perzgjedhura per tu trajtuar, te jete kryer paraprakisht vleresimi social-ekonomik ne familje nga strukturat sociale perkatese.

Masa e ndihmes ekonomike per cdo familje te behet sipas VKM nr.597, date 04.09.2019
“Per percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per NE” , i ndryshuar.

5- Për vazhdimin e procedurave te metejshme ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Finances.

Drejtoria Shërbimit Social
M.Bitri

Drejtoria Juridike
E.Kapllanaj

KRYETARI
ARMANDO SUBASHI

Ne mungese dhe me porosi

ZV/KRYETARE E BASHKISE
SUELA PRIFTI

